

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6738  
E shtunë, 22 tetor 2022  
çmimi 0.40

Driton Kuka pas vizitës te liderët e UÇK-së në Hagë: Unë dhe Majlinda besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AVOKATI I THAÇIT PËR SPECIALEN: PROCESI ËSHTË BIZAR, I PRISHUR DHE I NDOTUR



Avokati i ekipit të mbrojtjes së Thaçit, Luka Misiqi, ka folur për krijimin e Gjykatës Speciale në Hagë. Ai ka thënë se i gjithë procesi është bizar dhe i ndotur për faktin se kjo gjykatë u krijua nën pretendimet se UÇK-ja ka bërë trafikim organesh. "Nuk e shoh aspak të

arsyeshëm krijimin e Dhomave të Specializuara në Hagë. Ata gjykohen për disa akuzat që tashmë shihet se janë të kontaminuara dhe nuk qëndrojnë", ka thënë Misiqi, duke shtuar se gjykimi i ish-presidentit Thaçi do të nisë në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm

## MARRËVESHJA FINALE ME SERBINË DUHET TA KETË VULËN E SHBA-së



Vetëm kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së kryeministrit Albin Kurti për të diskutuar për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit që është mbajtur në zyrën e kryeministrit, Haradinaj para medieve ka bërë me dije se me Kurtin ka diskutuar për përmbajtjen e marrëveshjes potenciale me Serbinë. Haradinaj ka thënë se marrëveshja finale duhet ta ketë vulën e SHBA-së. Ndërsa zyra e kryeministrit ka njoftuar se Kurti e ka falënderuar Haradinajn për interesimin e vazhdueshëm në raport me dialogun

FAÇE 3

### AKTUALE



OSMANI PËR DRAFTSTATUTIN E ASOCIACIONIT: ËSHTË 'FAKE NEWS'

F. 3

SHKARKOHET REKTORI I UP-së, NASER SAHITI

F. 3

SVEÇLA RITHEKSOI ZOTIMIN E KOSOVËS PËR SHTYRJEN PËRPARA TË INICIATIVAVE NË KUADËR TË PROCESIT TË BERLINIT

F. 3

PSD-JA, AKSION SIMBOLIK: 'KUVEND JODEMOKRATIK'

F. 3

FSK-JA VAZHDON STËRVITJET ME INSTRUKTORËT E BRIGADËS AMERIKANE

F. 7

### EKONOMI

PAKOJA PËR RINGJALLJE EKONOMIKE: QEVERIA NDAN 19 MILIONË EURO

F. 8

KEDS-I FILLON PILOTPROJEKTIN PËR INSPEKTIMIN E RRJETIT ELEKTRIK ME DRON

F. 8

### SPORT



NORA GJAKOVA E ARGJENDTË NË ABU DHABI

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Mqedoni  
Xhepcisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mbx: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky: Duhet të bëjmë gjithçka që t'ia pamundësojmë Rusisë shkatërrimin e sistemit tonë energjetik

KIEV, 21 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka thënë liderëve të Bashkimit Evropian se sulmet ruse, që kanë shkatërruar një pjesë të madhe të infrastrukturës së energjisë, kanë qëllim nxitjen e një vale të re të migrantëve ukrainas drejt vendeve të bllokut evropian. "Terrori rus kundër objekteve të energjisë ka për qëllim krijimin e sa më shumë problemeve me rrymë dhe nxehtësi në Ukrainë këtë vjeshtë dhe dimër, ashtu që sa më shumë ukrainas të nisen drejt vendeve tuaja", ka thënë Zelensky nëpërmjet videolidhjes. Sipas tij, këto veprime duhet të kenë "përgjigje të menjëhershme", fillimisht nëpërmjet sistemeve të shumta për mbrojtje ajrore. "Ne duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur që t'ia pamundësojmë Rusisë shkatërrimin e sistemit tonë energjetik me raketa dhe dronë", ka thënë Zelensky.

Rusia ka shtuar numrin e sulmeve në objekte banesore dhe infrastrukturë prej 10 tetorit, duke përdorur kryesisht dronë kamikazë.

Ukraina dhe Perëndimi besojnë se ky lloj i dronit është prodhuar nga Irani.

Moska dhe Teherani i kanë hedhur poshtë akuzat.

Zelensky, po ashtu, ka paralajmëruar se Ukraina dyshon

që Rusia ka hedhur mina në digën e hidrocentralit që gjendet në Nova Kakhovka. Nëse minat shpërthejnë, ai ka thënë që më shumë se 80 vendbanime, përfshirë Hersonin, do të jenë në rrezik të vërshimeve.

Zelensky ka thënë se punëtorët ukrainas janë dëbuar nga hidrocentrali, duke e lënë atë në duart e rusëve. Sipas tij, Rusia "ka përgatitur gjithçka për ta kryer këtë sulm terrorist". Ai ka bërë thirrje për mision vëzhgues ndërkombëtar, kthim të punëtorëve dhe heqje të minave nga diga.

Komentet e Zelenskyt kanë ardhur dy ditë pasi Vladimir Saldo, zyrtar i emëruar nga Rusia në rajonin ukrainas të Hersonit, ka bërë me dije një "zhvendosjeje të organizuar" të civilëve nga katër qyteza afër Lumit Dnjepër.

Saldo i ka akuzuar forcat ukrainase se planifikojnë ta shkatërrojnë digën.

Autoritetet e instaluar nga Moska në Herson kanë thënë më 20 tetor se rreth 15 000 njerëz janë larguar nga rajoni.

Kievi e ka konsideruar këtë hap të Moskës si "dëbim" të civilëve ukrainas.

Mirëpo Stremousov ka thënë se njerëzit duhet t'i ndjekin udhëzimet dhe të largohen nga Hersoni, një prej katër rajoneve që janë aneksuar në mënyrë ilegale



nga Rusia. "Duhet t'i jepni ushtrisë një mundësi të bëjë atë që do të bëjë", ka thënë ai, duke pretenduar se ushtria ruse nuk do të heqë dorë nga Hersoni.

Ushtria ukrainase ka thënë më 21 tetor se Rusia është duke dërguar mijëra trupa ushtarake që ka mobilizuar së fundi në rajonin e Hersonit. "Mbi 2 000 rusë të mobilizuar kanë arritur në rajonin e pushtuar përkohësisht të Hersonit", ka njoftuar Shtabi i

Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës. "Në të njëjtën kohë, autoritetet pushtuese kanë lëshuar një urdhër për t'u përgatitur për një evakuim të punëtorëve shëndetësorë dhe mësuesve", është thënë në deklaratë.

Ukraina është duke tentuar që t'i shtyjë forcat ushtarake ruse përtej Lumit Dnjepër.

Ushtarët rusë që janë në këtë zonë raportohet se kanë pak furnizime

dhe kanë nevojë për përforcime. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke e goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Ballkani shqetëson BE-në: Do t'i rinegociojmë marrëveshjet për emigracionin e paligjshëm

BRUKSEL, 21 TETOR - Rruga ballkanike po rikthehet në shqetësim madhor për vendet e BE-së. Shumë prej emigrantëve të paligjshëm në bllokun evropian tani hyjnë nga Ballkani e vendet e bllokut duken të vendosura ta frenojnë këtë fenomen. Ministria e Brendshme e Gjermanisë, Nancy Faeser, ka deklaruar se duhet me çdo kusht "ta mbajmë nën kontroll migracionin e parregullt". Ajo ka thënë se migracioni nuk duhet t'u marrë hapësirë njerëzve që vërtet kanë nevojë në këtë kohë për një strehë në BE.

Në konferencën e Ballkanit Perëndimor morën pjesë 17 vendet e asociuara në Procesin e Berlinit, si dhe ministri i Brendshëm i Çekisë, si kryetare e radhës së BE-së. Komisionarja Ylva Johansson ka thënë pas takimit se BE-ja synon t'i bëjë ballë këtij fluksi të ri duke forcuar agjencinë për mbrojtjen e kufijve



Frontex. "Së shpejti do të bëjë marrëveshje të re bashkëpunimi me Maqedoninë e Veriut dhe,

gjithashtu, do t'i rinegociojmë të gjitha marrëveshjet ekzistuese me vendet e tjera të Ballkanit

Perëndimor, në mënyrë që ato të vihen në përdorim edhe ndërmjet vendeve të rajonit.

Sipas shifrave të BE-së, mbi 86 000 njerëz kanë hyrë në BE deri në fund të gushtit përmes Rrugës ballkanike. Kjo është tri herë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar", u shpreh komisionerja Johansson.

Sipas saj, bëhet fjalë për shtetas nga India, Kuba, Tunizia dhe Burundi. Një raport i fundit i Organizatës Evropiane të Kufijve Frontex që u referohet të dhënave të migrimit për nëntë muajt e vitit 2022 tregon se Rruga e Ballkanit Perëndimor vazhdon të jetë rruga më aktive e emigracionit për në vendet e Bashkimit Evropian.

Shqipëria është pjesë e Rrugës Ballkanike ku emigrantët e parregullt hyjnë nga Greqia dhe udhëtojnë drejt vendeve perëndimore duke kaluar drejt Malit të Zi apo përmes Portit të Durrësit për në Itali. Tendenca të emigrimit të paligjshëm janë shfaqur edhe përmes hapësirës detare nga Vlora në brigjet

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

## Osmani për draftstatutin e Asociacionit: Është 'fake news'

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Presidentja Vjosa Osmani ka folur të premten për iniciativën franko-gjermane e cila ka për synim dialogun Kosovë - Serbi. Osmani e ka mohuar qarkullimin e një "drafti gjerman" për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka thënë se ai është "fake news" dhe asnjëherë nuk u është dorëzuar institucioneve të Kosovës. Madje, sipas saj, nuk do të ketë asociacion i cili

do të bie ndesh me Kushtetutën, duke shtuar se kërkesa e partnerëve ndërkombëtarë nuk është kusht për themelimin e asociacionit.

"Sa i përket iniciativës franko-gjermane, ka për qëllim intensifikimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Do të ketë takime në javën e ardhshme. Ekipi i Macronit e Shcholzit do t'i sqarojnë në detaje. Deri tani qëllimi i

partnerëve tanë është i mirë, që procesi të përfundojë sa më parë dhe askush nuk ka kërkuar që të largohet njohja reciproke dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejojmë që të preken integriteti territorial dhe sovraniteti", ka thënë Osmani, duke shtuar se sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u ka thënë se nuk do të kërkojnë asgjë nga Kosova përpos atë që e parasheh Kushtetuta. "Është 'fake news'

që iu është adresuar institucioneve të Kosovës. Sekretari Blinken na ka thënë se nuk do të kërkojë diçka që është kundër Kushtetutës së Kosovës", ka thënë Osmani. Më tutje, Osmani ka thënë se kërkesa e ShBA-së është që Asociacioni të jetë në përputhje me Kushtetutën. Ajo ka thënë se, krahas kësaj, çdo marrëveshje që nuk është në frymën kushtetuese nuk do ta nënshkruajë. "Presidenca



vetëm dekreton marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo që mund ta rikonfirmoj është se do të nënshkruaj vetëm marrëveshje që janë në përputhje me Gjykatën Kushtetuese", ka thënë Osmani.

RAMUSH HARADINAJ, LIDERI I VETËM OPOZITAR QË I SHKON NË TAKIM KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI

## Marrëveshja finale me Serbinë duhet ta ketë vulën e ShBA-së

Vetëm kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së kryeministrit Albin Kurti për të diskutuar për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit që është mbajtur në zyrën e kryeministrit, Haradinaj para medieve ka bërë me dije se me Kurtin ka diskutuar për përmbajtjen e marrëveshjes potenciale me Serbinë. Haradinaj ka thënë se marrëveshja finale duhet ta ketë vulën e ShBA-së. Ndërsa zyra e kryeministrit ka njoftuar se Kurti e ka falënderuar Haradinajn për interesimin e vazhdueshëm në raport me dialogun

EPOKA  
ERE

Lirim GEÇI

PRISHTINË, 21 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të premten në takim kryetarin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj dhe nënkryetarin e parë të kësaj partie, Ardian Gjini, me të cilët ka biseduar për përmbajtjen e marrëveshjes potenciale me Serbinë. Ftesën e Kurtit për takim e kanë refuzuar lideri i PDK-së, Memli Krasniqi dhe ai i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Siç ka njoftuar zyra e kryeministrit, në këtë takim përmbajtjesor Kurti - Haradinaj është diskutuar për procesin e dialogut, idetë, modelet dhe opsionet për elementet kryesore të marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të cilat po qarkullojnë nëpër kancelaritë përëndimore e demokratike, e që në këtë periudhë funksionojnë si sprovë dhe testime. "Kryeministri Kurti e njoftoi kryetarin e AAK-së, z. Haradinaj, për takimet në Bruksel dhe Prishtinë, për

konstruktivitetin dhe kreativitetin e Kosovës përgjatë gjithë procesit të bisedimeve i cili duhet përmblyllur me normalizim të plotë të marrëdhënieve me njohjen reciproke në qendër", ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Sipas këtij njoftimi, Kurti e ka falënderuar kryetarin e AAK-së për interesimin e vazhdueshëm dhe të qenit aktiv për çështjen e marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

### Haradinaj: Marrëveshja përfundimtare duhet ta ketë vulën e Amerikës

Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, pas takimit me Kurtin, ka thënë para medieve se ka biseduar për përmbajtjen e një marrëveshjeje potenciale me Serbinë. Ai ka thënë se takimi me Kurtin ka qenë përmbajtjesor. "Diskutuam për procesin, diskutuam për marrëveshjen, për sfidat që i ka Kosova në këtë proces. Mund të them se ishte



takim me përmbajtje, sepse kemi diskutuar për përmbajtjen e një marrëveshjeje potenciale Kosovë - Serbi", ka thënë Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka thënë se finalizimi i këtij procesi duhet të bëhet me vulën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe se marrëveshja do të duhej të nënshkruhej në Uashington. "Duhet ta ketë vulën e Amerikës, jo vetëm mbështetjen e Amerikës. Për të qenë ky proces në garanci të plota, duhet të nënshkruhet edhe nga niveli i njëjtë amerikan", ka theksuar Haradinaj, duke bërë thirrje për qasje serioze në këtë fazë të dialogut. "Vendimet e dialogut nuk janë vendime që i ndryshon dikush më pas. Duhet të jemi sa më seriozë, duke marrë parasysh shkallën e seriozitetit të aktorit ndërkombëtar, duke parë sa seriozë janë Uashingtoni, Berlioni, Londra, Parisi. Ne duhet ta

konsiderojmë me shumë seriozitet këtë proces. Do të punojmë që Kosova të dalë e suksesshme. Nuk bëhet fjalë për agjenda të tjera, as zgjedhore, as qeverisëse", është shprehur Haradinaj.

Lideri i AAK-së nuk u është përgjigjur gazetarëve nëse në takim është diskutuar për të ashtuquajturin propozim franko-gjerman, që do të mund të ishte një kornizë e re për dialogun midis tyre, për arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme për normalizimin e raporteve.

Haradinaj është pyetur se cilat janë gjasat që AAK-ja t'i bashkohet qeverisë Kurtit në koalicion në prag të nënshkrimit të marrëveshjes me Serbinë. Haradinaj ka qenë i shkurtër në përgjigje duke thënë se gjasat për një gjë të tillë janë zero. Kryeministri Kurti u ka dërguar

ftesë edhe dy partive të tjera opozitare për të diskutuar për këtë çështje, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), mirëpo ato nuk kanë pranuar.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se ka vendosur të mos shkojë në takim me kryeministrin Albin Kurti të premten. Nëpërmjet një video-selfie të publikuar në "Facebook", i pari i PDK-së ka thënë se ftesa e kryeministrit Albin Kurti është joserioze, pa përmbajtje, pa agjendë dhe pa protokoll. "Vetëm pasi kërkuam sqarime, kuptuam me një fjalë përmes e-mailit se bëhej fjalë për një temë shumë serioze - siç është dialogu Kosovë - Serbi. Pa asnjë detaj konkret e pa specifikuar asgjë. Po jua rikujtoj që s'keni asnjë arsye që të na ftoni në takime për çështje teknike. Ndërsa kur të ketë diskutim konkret për marrëveshjen finale, ne do të jemi aty. Ka ditë që në opinion flitet për një dokument që ju e keni në tavolinë rreth marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve, të ofruar nga partnerët ndërkombëtarë të Kosovës", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa zëdhënësjë e LDK-së, Sibel Halimi, ka thënë se për temën e dialogut Kurti duhet të raportojë vetëm në Kuvendin e Kosovës.

Ftesa e Kurtit për takim me liderët e opozitës ka ardhur pas takimit që ka zhvilluar me emisararin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar.

## Sveçla ritheksoi zotimin e Kosovës për shtyrjen përpara të iniciativave në kuadër të Procesit të Berlinit

BERLIN, 21 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, me ftesën e ministres Federale të Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Nancy Faeser, mori pjesë në takimin e Ministrave të Brendshëm në kuadër të Procesit të Berlinit, përgjegjës për siguri të brendshme dhe migrim.

Me këtë rast, ministri Sveçla ritheksoi zotimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për

shtyrjen përpara të iniciativave nën kornizën e Procesit të Berlinit, si iniciativa që do të sjellin përfitime për regjionin dhe më gjerë.

Gjatë këtij takimi ministri Sveçla potencoi rëndësinë jo vetëm të bashkëpunimit rajonal, por dhe më gjerë për shkëmbimin e informacioneve me qëllim të luftimit të migrimit të parregullt, por edhe për rritjen e sigurisë në përgjithësi.

Gjithashtu, ministri Sveçla theksoi rezultatet e Republikës së Kosovës në luftën kundër kriminit dhe korrupsionit të cilat kanë ndikuar në rangimin e Kosovës si vendi i parë në Ballkanin Perëndimor nga Raporti Botëror i Drejtësisë në Sundimin e Ligjit si dhe përmirësimit për 17 vende në Indeksin e Transparency International.

Në fjalimin e tij ai ndau edhe përvojën e suksesshme të

Kosovës në fushën e luftimit të terrorizmit, në rikthimin dhe riintegrimin e shtetasve që kanë marrë pjesë në luftërat e huaja, kthimin e grave dhe fëmijë të tyre, si dhe rëndësinë e bashkëpunimeve operacionale dhe me shtetet e rajonit.

Sveçla theksoi se parakusht për bashkëpunim të sinqertë është trajtimi i barabartë jo vetëm ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor, por edhe nga vetë BE-ja, duke u zotuar se "ne do



të vazhdojmë të jemi partnerë seriozë në angazhimet tona të përbashkëta për sundimin e ligjit, si parakusht për progresin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës".



## Avokati i Thaçit për Specialen: Procesi është bizar, i prishur dhe i ndotur

Avokati i ekipit të mbrojtjes së Thaçit, Luka Misić, ka folur për krijimin e Gjykatës Speciale në Hagë. Ai ka thënë se i gjithë procesi është bizar dhe i ndotur për faktin se kjo gjykatë u krijua nën pretendimet se UÇK-ja ka bërë trafikim organesh. “Nuk e shoh aspak të arsyeshëm krijimin e Dhomave të Specializuara në Hagë. Ata gjykohen për disa akuza që tashmë shihet se janë të kontaminuara dhe nuk qëndrojnë”, ka thënë Misić, duke shtuar se gjykimi i ish-presidentit Thaçi do të nisë në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Avokati i ekipit të mbrojtjes së Thaçit, Luka Misić, e ka quajtur aspak të arsyeshëm krijimin e Dhomave të Specializuara në Hagë. Misić në “Prime Time” në Kanal10, ka deklaruar se, sipas tij, është një perceptim i qartë që nuk ka pasur nevojë të krijohet një gjykatë e cila do t’i gjykojë vetëm shqiptarët. “Nuk e shoh aspak të arsyeshëm krijimin e Dhomave të Specializuara në Hagë. Ata gjykohen për disa akuza që tashmë shihet se janë të

kontaminuara dhe nuk qëndrojnë. Besoj se ka një perceptim të qartë se nuk ka pasur nevojë të krijohet një gjykatë e cila do t’i gjykojë vetëm shqiptarët. Arsyet kryesore pse nuk ka qenë e nevojshme janë se është krijuar nën ligjet e Kosovës dhe kjo, në fakt, nuk do të mund t’i gjykojë asnjëherë serbët për kryerjen e krimeve në Kosovë, sepse Serbia do t’i mbrojë oficerët e saj dhe Kosova nuk mund të bëjë thirrje në Interpol për të arrestuar persona që nuk janë në territor të saj. Me këtë

rast, është bërë gjykatë e njëanshme sepse vetëm shqiptarët e Kosovës do të gjykohen, dhe kjo krijon një përshtypje negative, një përshtypje të mungesës së barazisë dhe drejtësisë, sepse besoj se ajo çfarë ndodhi në Kosovë, gjatë viteve 1998-99, tregon qartazi se kush ka nisur luftën, kush ka shkaktuar vuajtje të tmerrshme dhe kush po mbronte veten në atë luftë”, ka deklaruar ai.

Misić, duke folur për krijimin e Gjykatës Speciale në Hagë, ka

thënë se i gjithë procesi është bizar dhe i ndotur për faktin se gjykata u krijua nën pretendimet se UÇK-ja ka bërë trafikim organesh. “Jam shumë i shqetësuar, më duhet ta them. I gjithë procesi ka qenë shumë bizar dhe i prishur, i ndotur për faktin se e gjithë gjykata u krijua nën pretendimet e pabazuara për trafikim organesh nga UÇK-ja, e cila, sipas meje, ka qenë e vetmja arsye që ka tërhequr vëmendjen ndërkombëtare dhe vëmendjen e pjesëtarëve të Komunitetit Ndërkombëtar për t’i financuar këto Dhoma, ta rrisin presionin mbi Kosovën që ta miratojnë vetë ligjin për funksionalizimin e Dhomave të Specializuara, e gjitha kjo bazohej në raportin e Dick Martyt. Po ritheksoj, për ato titujt prekës, të shtyrë më së shumti nga Serbia dhe Rusia, me qëllim të okupimit të tokës së

Kosovës, që ishin kundër pavarësisë së Kosovës dhe vetë ekzistencës së saj”, ka thënë avokati Misić.

Avokati kroato-amerikan, Luka Misić, pjesë e ekipit të mbrojtjes së ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se gjykimi i ish-presidentit Thaçi me shumë mundësi do të nisë në tre muajt e parë të vitit të ardhshëm. “Faktikisht ne marrim informacionet ashtu si ju, nga zëdhënësi i kësaj gjykate. Rasti me shumë mundësi do t’i transferohet trupit gjykues nga fundi i vitit dhe gjykimi pastaj do të nisë në tre muajt e parë të 2023-s. Kaq dimë. Nëse flas realisht, bazuar në eksperiencën time, gjykimi mund të zgjasë nga 3 deri në 5 vjet para se ta marrësh qëndrimin fillestar nga gjykatësi”, ka deklaruar Misić. (Kanal10)

## Gucati dhe Haradinaj dalin para Gjykatës së Apelit në Speciale më 1 dhe 2 dhjetor

**HAGË, 21 TETOR** - Gjykata e Apelit e Dhomave të Specializuara në Hagë ka caktuar datën 1 dhe 2 dhjetor për mbajtjen e seancave për rastin e Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucati. Vendimi është marrë më 20 tetor nga gjyqtari Michele Picard. “Paneli i Gjykatës së Apelit cakton seancat dëgjimore për

të enjten e 1 dhjetorit 2022 dhe 2 dhjetor 2022”, thuhet në vendim.

Po në këtë vendim të Picardit udhëzohet mbrojtja që deri më 21 nëntor 2022 të tregojë nëse Guçati dhe Haradinaj dëshirojnë të marrin pjesë në seancë.

Në muajin maj 2022 Dhomat e Specializuara i shpallën

fajtorë Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn për pengim të administrimit të drejtësisë, duke i dënuar me nga katër vjet e gjysmë burgim dhe me një gjobë prej 100 eurosh. Në dënim do t’u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Ata në paraburgim kanë qëndruar prej shtatorit të vitit 2020.



## Driton Kuka, pas vizitës te liderët e UÇK-së në Hagë: Unë dhe Majlinda besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre

HAGË, 21 TETOR - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, së bashku me xhudistin dhe trajneren Majlinda Kelmendi, kanë vizituar drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë. Driton Kuka ka shkruar në "Facebook" se me drejtuesit e UÇK-së kanë biseduar për shumëçka, teksa ka theksuar se beson fuqishëm në pafajësinë e tyre. "Sot dhe dje së bashku me

Majlindën përfunduar vizitat me krerët e UÇK-së. Me secilin patëm biseda e shpalosje për ngjarjet historike të popullit tonë. Biseduam edhe për sfidat tona në sport tash e në të kaluarën. Të fortë, të qëndrueshëm, pozitivë dhe të motivuar për të dalë të pafajshëm, fillimisht ata, e më pas UÇK-ja dhe Republika e Kosovës, nga ky proces i padrejtë gjyqësor. Unë dhe Majlinda, njëjtë si qytetarët e Kosovës, besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre", ka shkruar Driton Kuka.



## Murati: Ripërcaktimi i kufijve ishte rast historik, do të rikthehet përsëri



PRISHTINË, 21 TETOR - Zgjidhja më e mirë për shtetin e Kosovës, sipas kryetarit të Lëvizjes për Bashkim, do të ishte ripërcaktimi i kufijve me Serbinë. Murati në "Debat Plus" në RTV Dukagjini ka thënë se Kosova në mënyrë të turpshme e kishte humbur rastin të cilin e ka cilësuar historik për ta zgjidhur çështjen e Kosovës dhe Serbisë përmes ripërcaktimit të kufijve.

Murati u shpreh se beson shumë se një ide e tillë do të kthehet përsëri pasi, sipas tij, formimi i Asociacionit me Shumicë të Komunave Serbe do të dështojë. "Ne e kemi futur veten me këtë qasje në rrugë qorre. E kemi lëshuar për turpin tonë rastin historik të zgjidhjes së problemit shqiptaro-serb përmes ripërcaktimit të kufijve. Pse kam besim që kthehet ajo? Sepse këto

do të dështojnë. Asociacioni do të dështojë në implementim. Domsdo do të kthehet, sepse nuk ka zgjidhje tjetër funksionale në mes të Kosovës dhe Serbisë, përpos të përfundojmë me një marrëveshje që kushtetutën e ndryshon, funksionalizohesh si shtet dhe e zgjidh problemin. Atëherë ndesh le të njohë Serbia ndesh jo, nuk na nevojitet njohja e Serbisë", ka theksuar ai.

Murati ka thënë se Kosovës nuk i nevojitet njohja nga Serbia nëse mbetet shtet jofunksional. Ai ka përmendur disa shtete të cilat janë pjesë e OKB-së, por nuk kanë stabilitet brenda. "Dua ta bëj shtetin funksional, duam të hyjmë në OKB, të na njohë Serbia dhe të mbesim brenda jofunksional. Edhe Sudani është në OKB, edhe Bosnja është, edhe Ukraina. Është dashur ta vendosim në qendër të

synimeve të përfundimit të dialogut rritjen e funksionalizimit të shtetit të Kosovës dhe zgjidhjen e problemeve, përfshirë shqiptarët e Luginës së Preshevës, të cilët kanë qenë hisenik në pavarësinë e Kosovës", ka thënë Murati. Murati e ka kritikuar kryeministrin Kurti për ide populiste, teksa ka thënë se ai nuk ka ide se si do të zgjidhet çështja në mes të Kosovës dhe Serbisë.

## Viola von Cramon-Taubadel, të hënën konferencë për medie në Prishtinë

PRISHTINË, 21 TETOR - Pas vizitës së saj në Kosovë dhe një sërë takimesh të nivelit të lartë, Viola von Cramon-Taubadel, raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian për Kosovën, do të mbajë konferencë për medie javën e ardhshme, të hënën, në

orën 9:30. Në Shtëpinë e Evropës në Prishtinë, raportuesja e Parlamentit Evropian do t'i paraqesë pikëpamjet e saj për situatën aktuale, posaçërisht në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave dhe diskutimet e fundit për këtë në Këshillin e BE-së, si

dhe gjendjen e dialogut Kosovë - Serbi. Sipas njoftimit të Zyrës së BE-së në Prishtinë, një pjesë e veçantë e konferencës për medie do t'i kushtohet situatës në Ballkanin Perëndimor dhe implikimeve të luftës në Ukrainë në aspektin e sigurisë.



## PSD-ja, aksion simbolik: 'Kuvend jodemokratik'

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 TETOR - Partia Socialdemokrate (PSD) ka mbajtur të premten një aksion simbolik të ndërtesës së Kuvendit të Kosovës. Te ky institucion kjo parti ka vënë mbishkrimin "Kuvend jodemokratik".

Aksioni kishte të bënte me peticionin e kësaj partie të nënshkruar për iniciimin e ligjit për faljen e gjobave të pandemisë që, sipas PSD-së, nuk është duke u futur në rend dite për votim. "E vonuan, e zvarritën, por nuk arritën ta ndalin. Peticioni i nënshkruar nga mbi 11 mijë qytetarë, ku kërkohet iniciimi i ligjit për faljen e gjobave të pandemisë,

tash së fundi kaloi të gjitha procedurat burokratike, por jo edhe lejimin e pjesëmarrjes në seancë ku diskutohet dhe votohet kjo temë. Është dekurajuese qasja e Kuvendit, përkatësisht kryeparlamentarit Konjufca, për qytetarët që kanë nevojë dhe organizohen rreth çështjeve në interes për ta. Demokracia përfaqësuese është më e gjerë sesa formaliteti i shtruar në institucione. Ligji e mundëson, deputeti e refuzon. Në vend se të nxiten iniciativat e tilla dhe të mbrohen direkt nga qytetarët, frika e pushtetit zuri ulësen e tyre. Këta përfaqësues janë të kapur ngushtë pas pushtetit të tyre", kanë thënë zyrtarët e PSD-së.



## Kuvendi i Shqipërisë voton pro ndryshimit të ligjit për dosjet e ish-Sigurimit

TIRANË, 21 TETOR - Kuvendi i Shqipërisë i ka hapur rrugë riverifikimit të të gjithë personave të dyshuar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit në kohën e komunizmit. Pas një seance maratone që ka zgjatur rreth 13 orë, Kuvendi ka miratuar në mesnatën e 20 tetorit ndryshimet në ligjin "për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit".

Ligji parashikon hapjen e dosjeve, deklasifikimin e të gjitha dokumenteve nga 29 nëntori 1944 deri më 2 korrik 1991 që gjenden në Arkivin e Shtetit.

Ndryshimet i mundësojnë çdokujt qasje të plotë.

Aktualisht, edhe pse mundësohet marrja e një kopjeje të dosjes, një pjesë e të dhënave nuk ofrohen të plota.



Ndryshimet janë miratuar me 94 vota për dhe një kundër pas shtimit të disa amendamenteve të kërkuara nga demokratët opozitarë.

Në këtë seancë nuk ka qenë i pranishëm kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha. Nisma e paraqitur nga Partia

Socialiste shfuqizon komisionet "Bezhani" dhe "Mezini", që kanë pajisur me 'certifikatë pastërtie' zyrtarë të ndryshëm dhe i jep të drejtë Autoritetit të Dosjeve ta rivlerësojë figurën e çdo zyrtari. Ky propozim i është paraqitur Kuvendit pas kërkesës së

Autoritetit të Dosjeve, bazuar nën dyshimet se ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit.

Meta është i pajisur me 'certifikatë pastërtie'.

"Të gjithë e dimë se kush na ka sjellë këtu sot. Ai është I. M. dhe gjithçka që thuhet për të në dosjet e ish-Sigurimit duhet të sqarohet", ka thënë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Kreu i grupit parlamentar i Partisë Demokratike, Enkelejd Alibeaj, ka thënë se hapja e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit do të duhej të ishte ndërmarrë shumë vjet më parë. "Nuk bëhet vetëm hapja e dosjeve për të parë kush kanë qenë bashkëpunëtorët e Sigurimit, por për të parë kush kanë qenë punëtorët, prokurorët, gjyqtarët, ekspertët

dhe gardianë burgjesh që vdekjen e njerëzve të pafajshëm e kanë pasur në bukën e tyre të përditshme. Na falni shqiptarë, ju që keni vuajtur, ju që nuk gjeni eshtrat, ju që keni hequr të zitë e ullirit nga punëtorë dhe bashkëpunëtorë të Sigurimit që kaq vonë u kujtuan për ju", ka thënë ai.

Sipas Autoritetit të Dosjeve, Ilir Meta ka bashkëpunuar me ish-Sigurimin e Shtetit, duke spiunuar shokun e tij Filip Talo. Autoriteti ka kërkuar heqjen e pengesës ligjore për ta verifikuar Metën dhe të gjithë ata që janë pajisur me 'certifikatën e pastërtisë'.

Ilir Meta ka mohuar se ka qenë bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit dhe i ka cilësuar akuzat të motivuara politikisht. Ai ka ngrehur kallëzim penal për anëtarët e Autoritetit.

## Shkarkohet rektori i UP-së, Naser Sahiti

PRISHTINË, 21 TETOR - Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka shkarkuar Naser Sahitin nga pozita e rektorit të këtij universiteti. Kryesuesi i Këshillit Drejtues të UP-së, Altin Sahiti, ka bërë me dije se

ushtruese e detyrës e rektores është emëruar Luljeta Plakolli-Kasumi. Për shkarkimin e Sahitit kanë votuar tetë anëtarë të Këshillit Drejtues të UP-së, ndërsa një anëtar ka abstenuar.

Më 19 tetor 19 organizata të

shoqërisë civile kanë dalë me një komunikatë të përbashkët për, siç kanë thënë, kundërshtimin e iniciimit për ta shkarkuar rektorin e Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, duke thënë se kjo po bëhet me akuza të pabaza.



## Osmani: Me përfshirjen e grave në proceset e paqes dhe sigurisë rriten shanset për paqe të qëndrueshme

PRISHTINË, 21 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pritur të premtën në takim zyrtarë e lartë të sekretarit të Shtetit në Zyrën për Çështje Globale të Grave (S/GWI), Katrina Fotovat. Në takim me Fotovat, presidentja Osmani ka theksuar se Forumi për Gratë, Paqen dhe Sigurinë me temë "Ndërtimi i Aleancave për Paqe të Qëndrueshme" po organizohet për herë të parë dhe përbën një nga zotimet në kuadër të Samiitit për Demokraci. Sipas Osmanit, Forumi është ngjarja e parë e

përmasave të tilla me pjesëmarrës nga 6 kontinente. Gratë e Republikës së Kosovës, sipas Osmanit, e kuptojnë shumë mirë rëndësinë e kësaj agjende. Presidentja Osmani theksoi se gratë e Kosovës janë shembulli më i mirë i angazhimit rreth kësaj agjende. Sipas presidentes Osmanit, ato shquhen posaçërisht për angazhimin aktiv drejt lehtësimit dhe ballafaqimit me pasojat e luftës dhe drejtësinë tranzicionale. Presidentja ka veçuar punën e

Komisionit Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës. Sipas presidentes Osmanit, edhe gratë nga shoqëria civile i kanë ndihmuar, gjithashtu, të mbijetuarat e dhunës seksuale. Presidentja Osmani ka shfaqur bindjen se me përfshirjen e grave në proceset e paqes dhe sigurisë rriten shanset për paqe të qëndrueshme. Palët janë pajtuar për bashkëpunim të rregullt për realizimin e projekteve të përbashkëta drejt avancimit dhe zbatimit të Agjendës GPS.



## Abazi: Të bëhet reforma zgjedhore, presidenti të zgjedhet nga qytetarët

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 TETOR - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Haki Abazi, ka folur të premtën për reformën zgjedhore duke propozuar ligji të ri për zgjedhjet. Ai ka thënë se reforma zgjedhore në Kosovë është stërzgatur për mungesë të vullnetit politik. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka theksuar se procesi i numërimit të votave duhet të digjitalizohet pasi aty komisionarët bëjnë pazare me votën e qytetarëve. Abazi ka kërkuar që presidenti të

zgjedhet nga qytetarët e jo përmes Kuvendit sikurse është zgjedhur deri më tani. "Në këtë konferencë do të flas për reformën zgjedhore. Më 1 korrik Kuvendi pati themeluar komisionin për reformë. Ky proces është stërzgatur në mungesë të vullnetit politik. Po ju thërras ta përcillini me kujdes këtë proces, sepse është i vetmi ligj që vullneti i qytetarëve të mos deformohet. Ligji që kemi ka lejuar deformimin për shkak të mungesës së mekanizmave. Masakrimi i votës ndodh gjatë numërimit të votave dhe në atë moment komisionarët bëjnë pazare se kujt do t'i takojnë votat

politike. Ligji i ri duhet ta largojë këtë manipulim. Puna e parë që duhet të bëhet është digjitalizimi i sistemit zgjedhor. Një pjesë e madhe e rajoneve mbetet e papërfaqësuar. Çështja tjetër është zgjedhja e presidentit nëpërmjet votës së qytetarëve. Ligji zgjedhor do ta parashohë përzgjedhjen e kandidatëve në listën e kandidatëve. Duhet të kemi garë të brendshme mes kandidatëve që të dalin në pah njerëzit me ide dhe vizion. Rikonfirmoj thirrjen për ta avancuar demokracinë që pjesëmarrja të jetë sa më e madhe", ka thënë deputeti i LV-së, Haki Abazi.



## FSK-ja vazhdon stërvitjet me instruktorët e Brigadës Amerikane

EPOKA  
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 21 TETOR - Trupat e forcave tokësore të FSK-së janë duke u stërvitur së bashku me trupat e forcave tokësore të Shqipërisë nga instruktorët e Brigadës Amerikane të Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB). "Regjimenti i parë i Këmbëorisë së

Forcave tona Tokësore është duke realizuar trajnimin në Republikën e Shqipërisë me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh) dhe Brigadën e Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) të ShBA-së", ka njoftuar ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Ai ka theksuar se Brigadat e Asistencës të Forcave të Sigurisë (SFAB) të ShBA-së janë njësi të

specializuara me misionin kryesor për të kryer stërvitje, këshillim, ndihmë, mundësim dhe shoqërim të operacioneve me vendet aleate dhe partnere. "Stërvitja ka për qëllim aftësimin në nivel taktik dhe operacional të trupave me qëllim të përgatitjes për validim të Regjimentit të Parë të Këmbëorisë", ka thënë ministri Mehaj.

Ndërsa karabinierët e forcave italiane janë duke i trajtuar policët ushtarakë të FSK-së në fushën e hetimeve. "Në kuadër të bashkëpunimit me karabinierët e forcave italiane dhe policisë sonë ushtarake, në Institutin e Avancuar të Karabinierisë për Teknikat e Hetimit në Romë të Italisë janë certifikuar dy policë tanë ushtarakë. Trajnimi ishte i fokusuar në

teknikat e hetimit dhe në trajtimin e rasteve, me fokus dhunën në baza gjinore, ku policët tanë kanë fituar njohuri dhe përvoja nga ekspertizat e shumta të ekspertëve të fushës së këtij instituti", ka thënë Mehaj, duke theksuar se ky trajnim është realizuar në vazhden e bashkëpunimit bilateral dhe partneritetit të ngushtë me ministrinë dhe forcat italiane.

# KEDS-i fillon pilotprojektin për inspektimin e rrjetit elektrik me dron

**PRISHTINË, 21 TETOR (ER)** - Kompania Kosovare për Distributum me Energji Elektrike (KEDS) ka bërë me dije se ka nisur monitorimin dhe inspektimin e rrjetit distributiv me dron. Fillimisht si pilot-projekt dronët janë aktivizuar gjatë ditëve të fundit të shtatorit dhe në fillim të tetorit mbi linjat 10 kV Keqekolla dhe 10 kV Restelica, që janë linja në terrene të vështira malore.

Në zona të tilla, për shkak të konfiguracionit të terrenit, ekipet e kanë të vështirë të depërtojnë për ta kryer punën e tyre, sidomos pas reshjeve atmosferike ose erërave të mëdha. Prandaj, një teknologji e tillë do të ndihmojë në uljen e rreziqeve për punëtorët e terrenit si dhe për shkurtimin e kohës së marrjes së të dhënave dhe intervenimit për sanimin e rrjetit apo prishjeve eventuale. “KEDS-i po e fut këtë teknologji të re për të vazhduar ndjekjen e trendëve të zhvillimit të kohës. Krahasuar me metodën tradicionale të inspektimit, atë me prani fizike të punëtorëve në lokacionin përkatës, e cila ka qenë mjaft e kufizuar dhe ka vështirësuar marrjen e të dhënave për gjendjen teknike të linjave të KEDS-it, teknologjia e re me dronë do ta lehtësojë dhe përshpejtojë procesin e grumbullimit të informatave nga terreni”, ka njoftuar

KEDS-i.

Sipas KEDS-it, një projekt i tillë do të zgjerohet dhe do t'i përfshijë të gjithë linjat ajrore të sistemit të shpërndarjes dhe pritet të fillojë implementimi nga janari i vitit 2023. Për fillim do të bëhet inspektimi i të gjitha linjave 6, 10, 20 dhe 35kV, për të vazhduar më tutje identifikimin e paraqitjes së defekteve potenciale të cilat në të ardhmen mund të shkaktojnë prishje dhe ndërprerje të energjisë elektrike.

“Për ta shkëmbyer përvojën e nevojshme për fillimin e një procesi të tillë për inspektimin e linjave ajrore, KEDS-i ka angazhuar kontraktorë të specializuar në këtë fushë, përderisa për implementimin e projektit do të ketë bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së KEDS. Dronët do të komandohen deri në 8 km nga distanca dhe do të bëjnë foto dhe video me rezolucion të lartë, në të cilat shihet qartë gjendja teknike e linjave shpërndarëse si dhe e elementeve përcjellëse të rrjetit të shpërndarjes. Videot ose fotografitë e gjeneruara nga dronët do të ndihmojnë në mirëmbajtje preventive të rrjetit dhe në investimet potenciale në të ardhmen, përderisa zonat më kritike do të detektohen me kohë për



caktim të prioriteteve dhe orientim të ekupeve punuese në këto zona. Kjo do të bëhet përmes aplikacionit softuerik 'uBird', në të cilin do të gjenerohen raporte të hollësishme që përmbajnë të gjitha informatat e nevojshme për linjën e inspektuar me dron, duke i klasifikuar gjetjet nga inspektimi sipas seriozitetit të dëmtimit dhe nevojës emergjente për intervenim”, ka njoftuar KEDS-i.

Këto të dhëna, sipas KEDS-it, do të analizohen nga ekipet profesionale të kompanisë, të cilat më pas do t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme për intervenim me qëllim të shmangies së prishjeve potenciale në të ardhmen, duke kontribuar në sigurinë e furnizimit me energji elektrike për regionet përkatëse. “Gjithashtu, të dhënat e marra nga procesi i inspektimit të linjave me dron do të përpunohen duke u

shfrytëzuar për analizë teknike të përgjithshme, me qëllim të përcaktimit të projekteve investive në të ardhmen. Përdorimi i dronëve në rrjetin shpërndarës të KEDS-it ofron një mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurt për inspektimin e plotë të linjave nga ekipet e terrenit, si dhe pritet të ndikojë në masë të madhe në besueshmërinë e furnizimit me energji elektrike për të gjithë konsumatorët”, ka njoftuar KEDS-i.

## Kërkohen alternativa për ngrohje në Kosovë

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Trendi i ngrohjes në Kosovë me energji elektrike nga KEDS-i është vlerësuar traditë e keqe. Nga ky institucion kanë thënë se kapacitetet vendore nuk i mbulojnë kërkesat e qytetarëve për energji dhe, për pasojë, vendi detyrohet të importojë energji me çmime të larta.

Ekspertët e energjisë kanë thënë se jodomsdoshmërisht duhet të ketë reduktime të energjisë dhe se qeveria duhet të gjejë zgjidhje për tejkallim të krizës.

Viktor Buzhala, zëdhënës i KEDS-it, ka thënë se kriza energjetike në Kosovë është shkaktuar nga kriza energjetike



në gjithë botën. Sipas tij, nuk dihet se si do të jetë furnizimi me energji tash e tutje. Buzhala ka thënë se në Kosovë

kapacitetet vendore gjatë dimrit nuk mjaftojnë për ta mbuluar kërkesën për energji. Ai ka thënë se duhet t'i

drejtohen importit, ndërsa çmimet e importit janë tejet të larta. “Jemi në situata totalisht të pasigurta, sepse kjo krizë është e importuar nga jashtë. Në tregjet e aksioneve çmimet e energjisë elektrike janë jashtëzakonisht të larta. Në Kosovë është krijuar një trend i ngrohjes me energji elektrike e cila është traditë e keqe, që nuk ekziston në asnjë vend të botës”, ka thënë Buzhala për “Radio Kosovën”.

Ndërsa eksperti i energjisë, Lulzim Syla, ka thënë se jodomsdoshmërisht mund të ketë reduktime të energjisë elektrike. “Faktori i parë është kujdesi për kursim të energjisë elektrike e që do t'i ndihmonte

shumë procesit të kursimit dhe kjo na ndihmon që bashkërisht ta kalojmë situatën më lehtë. Faktori i dytë janë parapërgatitjet që janë bërë dhe duhet të bëheshin nga ana e institucioneve shtetërore për mirëmbajtje të sistemeve energjetike. Faktori i tretë, i cili mund të jetë në favor tonin, temperaturat të mos jenë shumë të larta”, ka thënë Syla. Më tutje, Syla ka thënë se qeveria është vonuar pak në aspektin e implementimit të masave për tejkallimin e krizës energjetike. Ai ka theksuar se qeveria duhet të punojë intensivisht për gjetjen e zgjidhjeve sa më të mira për tejkallim të situatës.

## Pakoja për Ringjallje Ekonomike: Qeveria ndan 19 milionë euro

**PRISHTINË, 21 TETOR** - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike, në të cilën ka miratuar dy vendime për ndarjen e 19 milionë eurove për zbatimin e Pakos për Ringjallje

Ekonomike. Me vendimin e parë të miratuar në mbledhjen e 101-të të qeverisë janë ndarë pesë milionë euro (5.000.000,00 euro) për zbatimin e masës 3.7 Mbështetje për

tejkallimin e krizës energjetike në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike. Ndërsa me vendimin e dytë të miratuar në këtë mbledhje janë ndarë mjete buxhetore në shumën prej

katërmëdhjetë milionë eurosh (14.000.000,00 euro) për zbatimin e masave shtesë në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike, të masës 3.6 Mbështetja e likuiditetit familjar.





# David-ët dhe Goliat-ët gjeopolitikë



Nga Harold JAMES

Njujorkezët presin një kaos në trafik çdo muaj shtator kur mbledhet Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. Por këtë vit, duket sikur të gjithë janë të frustruar dhe të dëshpëruar, dhe përfaqësuesit nga e gjithë bota, po "garojnë" në thelb për të treguar se po ia kalon më keq se tjetri.

Për shembull Shtetet e Bashkuara janë të traumatizuara nga diskutimet mbi mundësinë e një lufte civile. Një pjesë e madhe e Partisë Republikane nuk premtion të pranojë rezultatet e zgjedhjeve të nëntorit. Por, ndërsa frika e inflacionit dhe recesionit ekonomik, do t'u japë republikanëve një avantazh ndaj demokratëve në zgjedhjet e mesit të mandatit, republikanët janë fokusuar në mobilizimin e bazës së vogël të mbështetësve të vijës së ashpër, të cilët kanë një axhendëthelësisht jopopullore që parashikon ndalimin e abortit dhe trajtimin çnjerëzor të emigrantëve.

Ndërkohë Britania e Madhe po përballet me kaosin pas Brexit dhe destabilizimin fiskal, që do të përkeqësohet kur qeveria e re do të zbatojë axhendën e saj që supozohet të jetë pro rritjes ekonomike. Pasi ka rrëzuar një qeveri të aftë dhe shumë të besueshme të kryesuar nga ish-presidenti i Bankës Qendrore Evropiane, Mario Dragi, Italia ka zgjedhur një qeveri të ekstremit të djathtë që nuk do të

bëjë asgjë për vendin, përveç thelmit të ndarjeve.

Në Francë, analistët janë të dëshpëruar me paaftësinë e presidentit Emanuel Makron për të nisur një axhendë të re reformash. Në Gjermani, një qeveri e re ka shpallur me guxim një ndryshim epokal (Zeitenwende), teksa po përpiqet të zbatojë pjesën më urgjente të kësaj axhende: rishikimin e politikës së mbrojtjes.

Në zgjedhjet parlamentare në Suedi, fitues rezultoi një parti e ekstremit të djathtë, që është e përkushtuar të sulmojë shtyllat kryesore të konsensusit politik të deritanishëm. Dhe në përgjithësi në Evropë, të rraskapitur intelektualisht nga një dekadë debatesh mbi ndërveprimet midis politikës monetare dhe fiskale, politikëbërësit e kanë gati të pamundur të hartojnë një strategji të për-bashkët mbi politikën energjetike. Por nga ana tjetër gjërat nuk po shkojnë mirë as për autokracitë e botës. Madje ato duket se po vuanjnë edhe më shumë sesa demokracitë kur është fjala për të mësuar nga katastrofat e kohëve të fundit, në mënyrë që të ndryshojnë kursin.

Kina e ka pasur të pamundur që të dalë nga strategjia e saj gjithnjë e më e kushtueshme e "zero-Covid". Ndërsa Rusia shërben si një shembull i tmerrshëm dhe i tmerrshëm se sa shpejt autokracitë e papërgjegjshme mund të bien në marrëzi vetë-shkatërruese.

Që të gjitha këto vende janë

mbërthyer në kurthe të krijuara nga fiksime të tyre historike, qofshin këto kujtime të poshtërimeve të dikurshme, pretendime për madhështi, apo të dyja bashkë. SharlDë Gol, i nisi kujtimet e tij të luftës me pretendimin se Franca nuk mund të ishte një vend pa madhështi.

Por nëse madhështi nënkupton t'u imponohesh fqinjëve, kjo nuk është diçka që duhet ta aspirojë ndonjë vend; dhe në botën e sotme shumë të ndërlikuar, as që është e realizueshme. Siç po e mësojnë tani udhëheqësit rusë, ëndrrat për hegjemoni çojnë në mënyrë të pashmangshme në rezistencë, kaos dhe vetë-shkatërrim.

Por ndërsa fuqitë e mëdha historike duan dëshpërimisht të gjejnë mënyra për të dalë nga ngërçi i tyre politik, disa vende më të vogla po duken gjithnjë e më të lumtura dhe më të qëndrueshme. Për t'i bashkuar ato si një kundërpeshë ndaj G7, G20 dhe grupimeve të tjera sklerotike, një nismë e re me bazë në Zvicër po përpiqet të krijojë një ligë shtetesh të vogla, të njohur si S8.

Katër nga 8 shtetet anëtare themeltare – Danimarka, Finlanda, Irlanda dhe Singapori – kanë popullsi prej 5-6 milionë banorësh. Por organizatorët mund të përfshijnë edhe vende të tjera të qëndrueshme që kanë të njëjtën madhësi, si Kosta Rika, Norvegjia dhe Sllovakia.

Në çdo rast, S8 përfaqëson pikë-pamjen se sfidat e dukshme nga të

qenit një vend i vogël, duhet të shihen më shumë si një shtysë për ofrimin e zgjidhjeve produktive, sesa si një justifikim për t'u zhytur në dëshpërim. Për shembull shihni Ukrainën, vend që padyshim është shumë i cënueshëm (edhe pse jo i vogël në krahasim me shumë të tjerë).

Kievi ka arritur që të zbehtë dobësinë e tij nëpërmjet një seri përgjigjesh të jashtëzakonshme ndaj agresionit rus. Ndërsa udhëheqësit e tij politikë kanë marrë mbështetjen ushtarake dhe financiare nga miqtë dhe aleatët në mbarë botën, zhvilluesit e talentuar të softuerëve kanë punuar gjatë gjithë kohës për t'iu kundërvënë sulmeve kibernetike ruse, dhe për të ndërmarrë sulmet e tyre.

Për vendet e vogla dhe të pambrojtura, të cilat nuk kanë një pozicion geografik shumë të favorshëm (si në rastin e Zvicrës), kërcënimet e sigurisë krijojnë nevojën për aleanca të forta, të cilat nga ana tjetër mund të jenë stabilizuese politikisht dhe ekonomikisht.

Për më tepër, një vend i fokusuar tek një kërcënim akut i jashtëm, ka shumë më pak gjasa që të zhytet në përplasje të brendshme. Nuk ka më të lehtë për një agresor të madh, sesa një vend i vogël i përçarë politikisht. Politika e konsensusit në Zvicër dhe Skandinavi, mbështetet tek themelet që u krijuan në kundërpërgjigje ndaj kërcënimit të paraqitur nga Gjermania naziste në vitet 1930.

Për shkak se vendet e vogla nuk

kanë ndonjë iluzion se mund t'u imponojnë të tjerëve vullnetin e tyre, ata ndajnë gatishmërinë për të përqaftuar fleksibilitetin dhe ndryshimin në një botë që kërkon përshtatshmëri. Dhe kur ato janë "të shkëlqyera", kjo ndodh sepse ato ofrojnë shembuj konkretë dhe praktikë se si mund të përmirësohet politika dhe qeverisja.

Për shembull, ndërsa Estonia e ka përforcuar legjitimitetin demokratik me futjen në zbatim të votimit elektronik, Kolumbia dhe Xhamajka janë në pararojë të përdorimit të monedhave dixhitale të mirë-projektuara nga ana e Bankës Qendrore.

Por nëse bota është duke iu larguar multilateralizmit dhe po ecën drejt një sistemi blloqesh konkurruese, vendet më të vogla do të jenë nën një presion edhe më të madh nga fuqitë e mëdha. Për të shmangur të qenit midis tyre si në një kurth, ato duhet të vazhdojnë të reformohen, si në politikë po ashtu edhe në teknologji. Duhet që ta bëjnë qeverinë përfaqësuese diçka reale, dhe jo simbolike, duke treguar se është më mirë të drejtohet përmes forcës së shembullit sesa përmes dominimit strategjik.

**Shënim:** Harold James, profesor i historisë dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Princeton. Ekspert i historisë ekonomike gjermane dhe globalizimit. Bashkautor i librit "Euro dhe beteja e ideve" / "Project Syndicate" – Bota.al

# E pyetën shqiptarin nëse do të shkojë në Ferr, dhe ai u përgjigj: Sa është rroga atje?

Dhjetori i vitit 1942 do të ishte dhjetori i fundit për Faik Konicën. I zhgënjyer nga raporti me mbretin Zog dhe duke parë atë çfarë po ndodhte në Shqipëri me luftën, ai u mbyll në shtëpinë e tij në Uashington duke iu dorëzuar shkrimit. Si ish-diplomat, pyetja me të cilën ndeshet shpesh, sa herë thoshte emrin e vendit që përfaqësonte, ishte “çfarë janë shqiptarët?” Në ShBA pas viteve 1940, Shqipëria ishte thjesht një vend i vogël në një cep të Ballkanit, me një histori po aq të trazuar sa rajoni në ato vite. Ky vend mund të haset rrallë në libra udhëtarësh të rastësishëm, apo studiuesish të gjuhës, por asnjë libër në ato vite nuk mund të tregonte një histori të vërtetë të shqiptarëve. I shtyrë dhe nga një botues amerikan, Konica ulet të shkruajë një histori të Shqipërisë, në formën e eseve. Fatë nuk deshi që Konica ta përfundonte këtë libër, por shënime të lëna pas janë sot një mënyrë për të parë një tablo të jetës sonë në ato vite. Këto shënime do të botoheshin shumë më vonë në një libër, “Shqipëria, Kopshti Shkëmbor i Europës Juglindore”, një libër që shënon dhe fillesat e prozës moderne shqiptare, nga ku janë shkëputur pjesët e mëposhtme.

Nga: Faik Konica (pjesë nga “Shqipëria, Kopshti Shkëmbor i Europës Juglindore”)



Faik Konica, njeriu që bëri të mos harrohet flamuri i Skënderbeut

## – 1 – Bizantinët

“Historiani bizantin, Nikiforos Gregoras, i cili nuk mund të dyshohet për simpatitë ndaj shqiptarëve, e përforcon faktin se shqiptarët nuk i vrasin, as nuk i shndërrojnë në skllavër, armiq të mundur. Është e vërtetë se Gregorasi përmend edhe emrat e disa kombësive të tjera të Perandorisë Bizantine që ndjekin po atë etikë luftarake, por edhe shembuj të ndryshëm, që dëshmojnë të kundërtën, mund të gjenden në kronikat e Bizantit. Sidoqoftë, në kohët e reja, në mes të kombeve të Europës Juglindore, vetëm shqiptarët i kanë qëndruar besnikë traditës kalorësiake që ta falin armikun e mundur”, shkruan Konica.

Duke folur për femrën, ai shkruan se “është diçka e ditur dhe e vërtetuar që në Shqipëri ‘gruaja gëzon paprekshmërinë’”. “Edhe në luftimet e gjaqet më të egra, gruan s’e trazon njeri. Kur dikush ka një armik, i cili ruan rastin t’i marrë hak, kur i duhet të udhëtojë, e ndien veten më të sigurt po të jetë i shoqëruar nga ndonjë grua; megjithëse kjo mënyrë veprimi quhet si jo burrërore. Edhe hajdutët e rrugëve i përmbahen këtij qëndrimi ndaj grave”, shkruan Konica.

Ai sjell në kujtesë një ngjarje që duhet të ketë ndodhur në vitet 1900 ku në shtypin botëror shkruhej për një ngjarje: treni ndërkombëtar “Orient Ekspres”, që udhëtonte nga Parisi në Stamboll, u sulmua nga kusarët e Thrakisë. Udhëtarët meshkuj u detyruan të linin trenin me gjithë plaçkat e veta. Ndërkaq, kryetari i bandës u tha grave të zinin vendet ku ishin më parë në tren dhe disa herë me radhë u kërkoi të falur për shqetësimin. Nga urdhrat

që u jepte shokëve të vet në gjuhën shqipe, u mor vesh kombësia e hajdutëve.

## – 2 – Turqit

“Të gjithë historianët turq bëjnë fjalë për kokëfortësinë shqiptare: ‘Arnaud iunud’ do të thotë ‘shqiptari kokëfortë’ dhe është një shprehje e zakonshme në kronikat e vjetra turke. Turqit mendojnë gjithashtu se shqiptarët janë gjaknxehtë. ‘E ka një dell shqiptari’, është një shprehje turke mjaft e përhapur.

Sir James Sedhouse, që e ka përfshirë këtë shprehje në fjalorin e vet monumental turqisht-anglisht, jep këtë përkufizim në botimin e ri të vitit 1921: ‘Arnauligi tuttu’ – filloi t’i lëvizë gjaku, flet a vepron, siç bën zakonisht një shqiptar, me vull. Sipas mendimit të komandantëve të vjetër turq, është me të vërtetë trim dhe shumë i zoti për të sulmuar, për të pushtuar ndonjë vend me mësymje, por qëndron indiferent kur kushtet kërkojnë taktikë mbrojtëse.

Reklama Sipas mendimit të turqve, interesi për para është një karakteristikë tjetër e shqiptarit, i cili është gati të futet në aventurat më të rrezikshme, mjaft që të nxjerrë ndonjë përfitim. E kishin zakon të tregonin një anekdotë në kohën e Perandorisë së vjetër turke: E pyetën shqiptarin një herë “a do të shkosh në ferr?” dhe ai u përgjigj “Sa është rroga atje?”.

## – 3 – Grekët

Ndërsa grekët kanë një tjetër mendim për shqiptarët. Në gjuhën popullore greke takojmë dy shprehje për shqiptarët. “Një kokë

shqiptari” thuhet për një njeri të papërkulshëm e kryeneç. Kur dikush vuan nga hallet që i kanë rënë përsipër, miqtë e ngushellojnë duke i thënë “haj se Zoti nuk është shqiptar”, që do të thotë se Zoti është i mëshirshëm.

“Kjo akuzë për mizori kuptohet fare mirë po të shikohet në dritën e historisë: grekët për qindra vjet me radhë i kanë njohur shqiptarët vetëm si pushtues, si kusarë që u plaçkitnin qytetet bregdetare, si ushtarë të dërguar ndër ekspedita ndëshkimore, si xhandarë ose si mbledhës taksash. Grekët nuk patën rast të njohin anën njerëzore të shqiptarëve”, shkruan Konica.

## – 4 – Italianët

Ajo çfarë e çudit atë janë italianët. “Italianët – dhe kjo të çudit shumë – megjithëse kanë pasur vazhdimisht marrëdhënie të ngushta dhe të afërme me shqiptarët, kanë vetëm një shprehje në lidhje me këtë popull. Edhe kjo nuk është diçka në favor të shqiptarëve. Shprehja ‘far l’albanese’ mund të gjendet në të gjithë fjalorët e mirë të italishtes, si për shembull, në atë të Nikola Zingarellit (Nicola Zingarelli). Përkthimi fjalë për fjalë i shprehjes është “të hiqesh si shqiptar”, kurse kuptimi është tjetër “bëj sikur s’kuptoj; hiqem sikur nuk di gjë”, shkruan Konica.

## – 5 – Anglezët

“Anglezët na kanë lënë disa vëzhgime të mprehta dhe të shkëlqyeshme mbi karakterin e shqiptarëve. Këto përshtypje, herë janë, herë nuk janë në favor të shqiptarëve, por vlejnë për sinqeritetin e tyre, mbasi shqiptarët për të cilët bëhej fjalë në ato studime

ishin analfabetë e prandaj të paaftë të falënderonin ose të protestonin për sa thuhej rreth tyre”, shkruan Konica.

William Martin Lik, i cili e filloi karrierën e vet si inxhinier ushtarak dhe e mbylli si arkeolog klasik, studimet e të cilit edhe pas një shekulli studiohen me nderim nga dijetarët, flet më se një herë në librat e vet për karakteristikat e shqiptarëve.

“Plutarku na vë në dijeni. – thotë Lik, – se Pirroja ishte një oborrar i shkathët dhe që në rini përpiquej të fitonte miqësinë e njerëzve të fuqishëm. Ky është në përgjithësi karakteri i shqiptarëve. Ata përpiquej me çdo mënyrë të sigurojnë mbrojtjen e eprorëve të tyre dhe u qëndrojnë besnikë, kur paguhen rregullisht. Kryengritjet e tyre të shpeshta zakonisht shkaktohen nga sjellja e pabesë e zyrtarëve, të cilët ndërmarrin disa punë pa siguruar më parë mjetet e duhura financiare. Shqiptarët, duke qenë zakonisht më të varfër se turqit, janë të kufizuar në kërkesat e veta, janë më të qëndrueshëm e të durueshëm, janë më të regjuri me vështirësitë që në moshë të njomë”.

Në një vend tjetër, koloneli Lik shpreh këtë mendim: “Ndërsa turku krenar dhe përtac dhe fshatari i varfër grek paraqiten shpeshherë pa pikë energjie, si pasojë e shtypjes dhe e varfërisë së vazhdueshme, këta shqiptarët dallohen për veprimtarinë e tyre të palodhur. Ata i zinin të parët pikat më të larta anës udhës, sikur ishin në garë cili do të ngjitej i pari. Të gjitha pyetjeve në lidhje me topografinë u përgjigjeshin me zgjuars, lejen për të shikuar me teleskopin tim e quajnë si një shpërblim të madh. Nuk ka dy gjëra në këtë botë që ndryshojnë më tepër në mes tyre se sa zakonet, (sjelljet) e shqiptarëve me ato të osmanllinjve”.

## – 6 – Gjermanët

Një dijetar gjerman, dr. Herbert Louis, i cili, siç e kemi thënë edhe më parë, ishte ngarkuar nga qeveria shqiptare të studioje topografinë e vendit, deklaroi se në Shqipëri nuk ekziston kuptimi i fjalës turmë.

“Një nga përshtypjet më të forta, – deklaroi dr. Louisi – që më ka mbetur nga shqiptarët, është ajo që te secili prej tyre vihet re një njeri me besim të madh në vetvete. Çdo individ, qoftë i zgjuar ose budalla, ka një aftësi të dukshme për të vendosur vetë dhe është mësuar të trajtojë pasurinë dhe jetën e vet në mënyrë praktike. Në një situatë të paqartë, secili jep një gjykim dhe është i gatshëm për nisma të guximshme. Me fjalë të tjera, në Shqipëri nuk ekzistojnë masa indiferente”.

“Kjo mungesë e frymës së turmës ka pasur pasoja fatale për unitetin e Shqipërisë, pasi secili përpiquej të merrte pjesë drejtpërsëdrejti personalisht, pa ndërmjetës ose të deleguar, në diskutimin e punëve publike. Ideja e shtetit për shqiptarin nuk kalonte përtej caqeve të qytetit ose përtej maleve ku banonte.

Ashtu si për grekët e vjetër dhe për italianët e mesjetës, ideali i shqiptarit ishte ai i një qyteti shtet. Në rastet kur çështja kombëtare kërkonte unitet veprimi, vetëm mbas diskutimesh pa fund arrihej të merreshin masa të përbashkëta, por edhe këto shumë herë tepër me vonesë. Nëse Shqipëria u nënshtrua nga të huajt në të kaluarën, gjithmonë ndodhte për fajin e një qëndrese të pakombinuar”, shkruan Konica. /Gazeta “Dita”

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Ermal Krasniqi, "Ylli i javës" në Superligë

PRISHTINË, 21 TETOR (ER) - Lojtari i Ballkanit, Ermal Krasniqi, është zgjedhur "Ylli i javës" në Superligën e Kosovës në futboll. Krasniqi ka shkëlqyer në ndeshjen që Ballkani e ka fituar ndaj Trepçës '89.

Lajmin e ka dhënë Federata e Futbollit e Kosovës (FFK). Me këtë rast, Krasniqi ka thënë se Ballkani është në rrugën e duhur për ta mbrojtur titullin kampion. "Çmimi 'Ylli i javës' është i pari për mua në këtë edicion të Albi Superligës dhe

jam shumë i lumtur. Ky çmim është meritë e tërë bashkëlojtarëve, pasi nuk po kursehem për të arritur rezultate të mira në Albi Mall Superligë përkundër angazhimit maksimal në ndeshjet e UEFA Conference

League. FC Ballkani është në rrugën e duhur për ta mbrojtur titullin kampion dhe, pavarësisht që nuk do të jetë e lehtë, besoj se ne do të shpallemi sërish kampionë të Kosovës", ka theksuar Krasniqi për faqen zyrtare të FFK-së.



## Nora Gjakova e argjendtë në Abu Dhabi

Xhudistja nga Kosova, Nora Gjakova është ndalur në finale, pasi ka humbur nga koreania Mim Huh

Pejania ka arritur t'ia sigurojë Kosovës medaljen e argjendtë në Abu Dhabi, në kategorinë -57 kilogramë.

Në raudin e parë ajo ka mposhtur koreanen Shin Yuna për të kaluar më pas në raundin tjetër ku triumfoi ndaj holandezes Pleuni Conrelisse.

Në raudin tjetër, Gjakova ka arritur të fitojë ndaj serbes Maria Perisic.

Kurse drejt finale të Grand Slamit të xhudos pejania ka arritur duke mposhtur gjeorgjianen Liparteliani.

Në finale, Nora Gjakova është mposhtur nga koreania Mim Huh, duke siguruar medaljen e argjendtë për Kosovën.



## Donjeta Sadiku, e bronztë në Budva

Donjeta Sadiku do të vije me medalje në Kosovë. Boksierja e ka fituar medaljen e bronzit të Evropës.

Sadiku pësoi humbje në gjysmëfinale nga kampionia olimpike Tokio 2020 Kellie Harrington e Irlandës,

kategoria -60 kg e Kampionatit Evropian, që po mbahet në Budva të Malit të Zi.

Është kjo medalja e parë evropiane për senior për Federatën e Boksit të Kosovës.



## Java e 13-të në Superligë, vëmendja në kryeqytet



Prishtinë, 21 tetor - Fundjava sjell xhiron e 13-të të Superligës në futboll. Ndeshja më interesante e javës zhvillohet sot (e shtunë) kryeqytet. Prishtina e pret Llapin në orën 18:00. Kryeqytetasit hyjnë të motivuar në këtë përballje, pas dy fitoreve radhazi. "Bardhekaltrit" janë në vendin e tretë me 18 pikë dhe kanë pesë pikë më shumë se Ilapjanët, të cilët kanë një ndeshje më pak të zhvilluar.

Ballafaqimi tjetër i së shtunës do të jetë në mes të Dritës dhe

Ferizajt, me gjilanasit që janë favoritë në letër. Drita u njoftua me humbjen e parë kampionale javën e kaluar, derisa vazhdon të jetë në krye të tabelës, kurse Ferizaj po përballet me formë të dobët, pasi u deklasua në mesjavë nga Malisheva 6:0.

E diela vjen me tri ndeshje. Ndeshje interesante na pret në Mitrovicë, Trepça '89 takohet me Gjilanan, që është jashtë formës. As '89-shi nuk po kalon çaste të mira, pasi është i teti në tabelë, me dy pikë larg vendit të fundit. Të

kuqtë nga Gjilani janë të katërtit. Kampioni në fuqi, Ballkani, i shkon Dukagjinit në kërkim të fitores dhe në pritje të një gabimi eventual të Dritës, për të kaluar në pozitën e parë. Në anën tjetër, klinasit janë të parafundit me tetë pikë.

Përballja e fundit zhvillohet në Skenderaj. Drenica takohet me Malishevën. Të dyja skuadrat kanë marrë fitore të mëdha në mesjavë, ndërsa dallimi në mes tyre është katër pikë. Më lart janë të renditur drenicasit.

## Mbappe, gjithnjë e më afër Premierë Ligës

PARIS, 21 TETOR - Largimi i Kylian Mbappes nga Paris Saint-Germain (PSG) vazhdon të marrë formë. Edhe pse francezi ka pretenduar se lajmi i publikuar disa ditë më parë është i rremë, se ai ka kërkuar të largohet në janar, realiteti është se ai mbetet i pakënaqur në Paris dhe largimi i tij në fund të sezonit mund të bëhet i mundur. Real Madridi është destinacioni i

ëndrrave për Kylian. Megjithatë, në klub, nënshkrimi i tij nuk mendohet më, të paktën tani për tani. Florentino Perez ka treguar tashmë se të gjitha lajmet për largimin e Mbappes e mërzi tën dhe nuk i interesojnë Los Blancos.

Pra, e vetmja rrugë e vërtetë shpëtimi për francezin është Premierë Liga. Në fakt, familja e tij tashmë ka dhënë dritën jeshile

për lëvizjen e tij në Angli, sipas "L'Equipe".

Xhaxhai i tij është thënë se i ka treguar Mbappes se Premierë Liga "është destinacioni më i mirë për të".

Por, cilat skuadra mund të nënshkruajnë me Mbappen? Premierë Liga ka fuqi të madhe ekonomike. Ka disa skuadra të afta për të përballuar një operacion të tillë, veçanërisht dy:

Manchester City dhe Liverpooi. "Qytetarët" që kanë nënshkruar me Erling Haalandin në verë, nëse do ta transferonin edhe Mbappen, do të kishin dy nga lojtarët më të mirë në botë.

Megjithatë, duket se nuk ka gjasa që ata t'i bashkojnë të dy për momentin, veçanërisht duke ditur egon që ka Mbappe, pasi do të jetë ylli i skuadrës. Nga ana tjetër, Liverpooi është



favoriti për ta marrë francezin. Jurgen Klopp e admiron Mbappen dhe francezi mund të jetë i lumtur me idenë për të luajtur në "Anfield Road".



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada-Government  
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1519/1  
 Dt. 21.10.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 07/2017, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

### Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj në paralelen e ndarë në Prizren për pozitën mësimdhënës/e për nivelin 5 të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"**

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka zhvilluar nivelin e 5 (pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Për këtë gjeneratë kualifikim "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" do të ofrohet në Qendrën e Kompetencës (QeK) - -Ferizaj" -dhe në paralelet e ndara: Qendrën Burimore "Përparimi" - Prishtinë, Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeqovi" - Prishtinë, Qendrën Burimore "Lef Nosi" - Prizren, dhe Qendrën Burimore "Nëna Terezë - Mitrovicë. Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Prizren	1 (një) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimin

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me standartin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;
- Bënë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes së cilësisë dhe transferimin e njohurive dhe shkathtësive adekuata te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veglat adekuate juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

#### Kualifikimi dhe dokumentacioni i kërkuara për pozitën mësimdhënës/e:

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt.

#### Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

#### Procedurat e konkurimit

Afati i konkurimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHTI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p.n, Prishtinë. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Boban Zajic shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Emir Susuri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhurë.

-Aleksandar Jovanovic shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Flamur Qilingeri shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Dëshmorët e Zhurit" Zhurë.

- Dritan Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frashëri " Vlashnje.

- Ismajl Prokshi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- "Rita Lakna 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811583790.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa



Trembëdhjetë vite pa më të dashurën tonë



## (Naile Rama Shpati)

(17 maj 1965 - 22 tetor 2009)

Vitet që kalojnë kurrë nuk do ta shuajnë dhimbjen, kujtimin, dashurinë dhe respektin për Ty.

13 vite kaluan dhe ne ende nuk pajtohemi që ti shkove nga kjo botë!

Vdekja jote e hershme mbeti plagë në zemrat tona. Shpresojmë motër që do të takohemi në parajsë dhe do të bashkohemi përgjithmonë.

**Të përkujtojnë fëmijët: djali Shendriti vajzat, Anita, Arbenita, Eronita bashkëshorti Dini motra Shehria me fëmijët.**





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

